



KRYETARI I KOMUNËS 01-Nr-465 58705 Datë 09.12.2020

Në bazë të nenit 4 pika 2, 2.4 dhe 3.3, neni 8 pika 5, të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme Nr.03/L-139 me ndryshim dhe plotësime e bëra me Ligjin Nr.03/L-205, dhe neni 44 të LPPA-së nr-05/ L.031, Vendimit të Kuvendit të Komunës së Suharekës për shpalljen e interesit të përgjithshëm 01-Nr-016-53056 me datë 30.10.2020 si dhe kërkesës së Drejtorisë për Shërbime Publike të Komunës së Suharekës, 01-104-48631, datë 12.10.2020 për shpronësimin e pronës së paluajtshme për interes publik dhe për ndërtimin e rrugës publike në Suharekë, Kryetari i Komunës së Suharekës, merrë këtë :

V E N D I M

Aprovohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës së subjektit kërkuar-Drejtorisë për shërbime Publike e Komunës së Suharekës, për shpronësimin e pronës së paluajtshme, pronë private e pronarve dhe zotuesve të interesit, për interes publik dhe për ndërtimin e rrugës publike në Suharekë e cila gjindet në ngastrat kadastrale me nr.P-72116046-02816-4, në sip. prej: 51 m2 dhe ngastrën kadastrale me nr.P-72116046-02816-7, në sip. prej : 1060 m2, te evidentuara në emër të Muhamet (Xhemajli) Elshani, Zk. Suharekë.

2. Vlera e kompenzimit të pronës së cekur në piken 1. të këtijë Vendimi, caktohet nga Ministria e Financave-Zyra e veçant për vlersimin e pronës së paluajtshme, konform Ligjit për Shpronësimin e pronës së paluajtshme Nr.03L-139 me ndryshim dhe plotësime e bëra me Ligjin Nr-03/L-205 për zbatimin e metodeve dhe kriterëve teknike të vlersimit që do të përdoren për përllogaritjen e shumës së kompenzimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin.

3. Për zbatimin e këtijë Vendimi, obligohet Departamenti për shpronësim në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastrë.

4. Ky Vendim hynë në fuqi ditën e publikimit në Gazetën zyrtare të Kosovës dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Rep. Kosovës.

Iu dërgohet:

Subjektit kërkuar;

Pronarit dhe zotëruesit të interesit dhe

Arkivit.

Kryetari i Komunës
Bali Muharemaj